

zhavorrit, hekurit, dhe e rreth 900 metro kub beton etj. në një hapësirë publike të gjelbër që quhet Parku i Madh i Tiranës, mendojmë së ndërtimi të Parku i Liqenit Artificial është në kundërshtim me shumë ligje vendase, komunitare dhe ndërkombëtare. Për pasojë leja e KKT nr1, datë 12.02.2016 është e pavlefshme sipas Kodit të Procedurës Administrative⁶, është nxjerë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, pasi është një veprim juridik apsolutisht i pavlefshëm dhe bie në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit. Për këto fakte, mendoj se publiku legjitimohet t'i drejtohet gjykatës si për ngritjen e padisë në themel ashtu edhe për kërkim të Sigurimit të Padisë si dhe dëmeve të shkaktuara në mjedis nga kjo veprimtari.

Po ashtu në rastin e Parkut të Liqenit Artificial Tiranë, është shkelur edhe Konventa e Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, ratifikuar me ligjin nr 8672/20001 si dhe një sërë ligjesh dhe aktesh të tjera⁷.

Kësisoj publiku i ndikuar personat fizik dhe juridik legjitimohen për ngritjen e padisë për pavlefshmërinë e aktit juridik, rikthimin në gjendjen e mëparshme dhe kërkimin e dëmshpërblimit për shkak të dëmit mjedisor të shkaktuar nga i padituri.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
Konventa e Aarhusit
Kodi i Procedurave Administrative
Kodi Civil
Kodi i Procedurës Civile
Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
Ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”
Ligji nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”
Vendimi i KKT-së, nr.4, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si kurora e gjelbër e Tiranës”
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e kurorës së gjelbër të Tiranës dhe masat për mbrojtjen e saj”
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”

⁶ Kodi i Procedurave Administrative, neni 116 pika c.

⁷ Mendoj që ligje të tjera të shkelura janë edhe: ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”; ligji nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis; Vendimi i KKT-së, nr.4, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si kurora e gjelbër e Tiranës”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e kurorës së gjelbër të Tiranës dhe masat për mbrojtjen e saj”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

Vështrim i shkurtër krahasimor ndërmjet legjislacionit të BE-së dhe legjislacionit të SHBA-së në fushën e së drejtës së autorit

Dnt. Enejda Shyti

Abstrakt

Zhvillimi i njerëzimit ka ardhur si rezultat i aftësive të krijimtarisë njerëzore, të cilat sjellin progresin ekonomik, social dhe atë kulturor. Në këtë kuadër, duke marrë parasysh rëndësinë që ka krijimtaria njerëzore, është e nevojshme që asaj t'i sigurohet mbrojtje në nivelet e duhura. Kjo mbrojtje duhet të akordohet nga legjislacioni përkatës për mbrojtjen e së drejtës së autorit. E drejta e autorit ka gjetur mbrojtje ligjore nga shumica e legjislacioneve në botë. Megjithatë, mbrojtja që i bëhet kësaj të drejte nuk është e njëjtë kudo. Kështu, mënyra e realizimit të mbrojtjes ligjore, që i sigurohet të drejtës së autorit në SHBA ndryshon nga ajo në Bashkimin Europian, sepse edhe vetë legjislacionet respektive janë zhvilluar mbi baza dhe koncepte të ndryshme ligjore. Legjislacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fushën e së drejtës së autorit mbështetet në Common Law dhe në konceptin e “Fair Use”, ndërsa sistemi evropian i së drejtës së autorit e ka origjinën e tij nga e drejta romake dhe nga e ashtuquajtura “paternity right”. Qëllimi i punimit është të evidentojë elementet kryesore të legjislacionit mbrojtës së të drejtës së autorit në BE dhe SHBA, në mënyrë që më pas të fokusohet në një vështrim krahasimor ndërmjet tyre, duke prezantuar qartë ngjashmëritë, ndryshimet dhe përparësitë e secilit prej tyre. Gjithshka këtu, do të konkretizohet duke iu referuar çështjeve të ndryshme gjyqësore.

Fjalë kyç – *Bashkimi Europian, SHBA, e drejta e autorit, legjislacion, Fair Use.*

Hyrje - Qëllimi i krijimit të legjislacionit të BE-së për të drejtën e autorit

Fillesa e Bashkimit European e ka origjinën e saj në krijimin e një tregu të përbashkët, ndaj në kuptimin e saj të përgjithshëm, e drejta e autorit në legjislacionin e BE-së, është konsideruar pjesë e rëndësishme e legjislacionit european për të kryer rregullimin ligjor të shumë çështjeve, që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin e tregut unik european.

Zhdukja e kufinjve të brendshëm në Bashkimin European nuk do të kuptojë uljen e nivelit të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve, krijuesve dhe bizneseve. Liria e qarkullimit të personave, shërbimeve, kapitaleve dhe mallrave janë përforcuar nga politika që synojnë luftën ndaj aktiviteteve ilegale, duke i dhënë përparësi tregëtisë mbi baza të mirëfillta ligjore, si dhe mbrojtjen e interesave të individëve dhe bizneseve të tyre. Për të krijuar një treg unik në Evropë, duhen eliminuar ose në pamundësi duhen reduktuar maksimalisht kufizimet mbi lirinë e lëvizjes dhe praktikave antikonkurrenciale, duke krijuar një ambient të favorshëm për risitë në teknologji dhe investimet në fushat kryesore të ekonomisë. Në këtë kontekst, mbrojtja e pronësisë¹ intelektuale dhe veçanërisht mbrojtja e së drejtës së autorit është një element esencial për suksesin e Tregut Unik European. Të gjitha masat e marra në nivel komunitar mbi pronësisë intelektuale, janë të nevojshme për funksionimin e tregut unik dhe janë projektuar për të krijuar një mjedis ligjor, të harmonizuar për përfitimin e gjithsecilit që vepron në industri dhe tregti.

Pronësia intelektuale mbulon një hapësirë të të drejtave të ndryshme, të cilat janë duke u harmonizuar gradualisht me qëllimin final për të siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje, e cila garanton lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve. Brenda Bashkimit European, e drejta e autorit (copyright) rregullohet nga çdo shtet me të drejtën e brendshme të tij, ndaj edhe Shtetet Anëtare të BE-së deri vonë kanë ruajtur autonominë e tyre në këtë fushë. Në këtë kuadër, theksojmë faktin se ligjet mbi të drejtën e autorit ndryshojnë në Vendet Anëtare të BE-së, sidomos ndërmjet vendeve në të cilat zbatohet sistemi *Common Law* (Qipro, Irlanda, Malta dhe Britania e Madhe) dhe vendeve të sistemit *Civil Law*. Për këto arsye, ishte mëse i nevojshëm harmonizimi i kuadrit ligjor brenda Bashkimit European.

Megjithatë, meqenëse shumica e shteteve të BE-së janë palë në marrëveshjet², traktatet dhe konventat ndërkombëtare që mbrojnë të drejtën e autorit në nivel global, zbatimi i detyrimeve të këtyre konventave ka qënë i detyrueshëm për këto shtete, si dhe ka kryer deri diku një unifikim të përgjithshëm global, për sa i përket

parimeve kryesore të së drejtës së autorit dhe mjeteve për mbrojtjen e saj.

Ky konsiderohet një hap i madh përpara, por në të njëjtën kohë duhet njohur fakti që shumica e konventave shumëpalëshe dhe veçanërisht ato të rishikuara në fund të viteve '60 dhe fillim të viteve '70, nuk japin një përgjigje të plotë për të gjitha pyetjet, te cilat mund të ngrihen rreth çështjeve komplekse që i përkasin të drejtës së autorit³, e në mënyrë të veçante atyre pyetjeve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimet teknologjike e industriale të kohëve të fundit. Natyrisht, që tregu unik shpesh kërkon një harmonizim më të strukturuar të legjislacionit kombëtar, sesa kërkojnë konventat ndërkombëtare. Kështu që, megjithëse veprimi shumëpalësh është i nevojshëm, nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tregut të përbashkët european.

Komuniteti European ndërmori hapat e para reale në fushën e pronësisë intelektuale në gjysmën e dytë të viteve '70, por vetëm me krijimin e tregut unik u siguria shtytja vendimtare për harmonizimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Qëllimi ishte të sigurohej që mallrat dhe shërbimet e mbrojtura nga këto të drejta, mund të lëviznin lirish. Një mbajtës i të drejtës së autorit duhej të ishte në gjendje të trajtonte komunitetin⁴ si një treg unik vendas, që do të thoshte që mbrojtja e mundshme duhej të ishte e njëjtë në të gjitha Vendet Anëtare. Ndryshimet⁵ që do të pengonin arritjen e këtij qëllimi, duhet të eliminohehin me anë të masave të miratuara në nivel komunitar. Megjithatë fillimisht, veprimi i Komunitetit mori formën e vendosjes në një linjë të legjislacionit të pronësisë intelektuale (dhe të drejtës së autorit si pjesë e saj) të Vendeve Anëtare me qëllim për të eliminuar ndryshimet e trajtimit, të cilat ndërhynin në lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe mallrave. Përpjekjet u përqëndruan në fushat ku ndryshimet ishin më shumë të theksuara, ose atje ku kishte pengesa të pajustificuara për lëvizjen e lirë.

Për këtë arsye, rreth viteve '80, duke pasur parasysh mënyrat e ndryshme ligjore të rregullimit dhe trajtimit të së drejtës së autorit, shkallën e ndryshme të zbatimit të ligjeve kombëtare në Vendet Anëtare, si dhe zhvillimin e vullshëm teknologjik të saj kohe, u pa e arsyeshme të krijoheshin disa rregulla të përbashkëta në fushën e së drejtës së autorit për të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së. Pikërisht, legjislacioni i së drejtës së autorit në BE është lartësuar në përpjekje për të harmonizuar nocionet dhe interpretimet e ndryshme, që kjo e drejtë merrte në Vendet Anëtare të Bashkimit European. Parimet bazë, ku mbështeten të gjitha aktet e BE-së në lidhje me të drejtën e autorit, konsistojnë në idenë se mbrojtja e pronësisë intelektuale konsiderohet domosdoshmëri për suksesin e tregut⁶ të brendshëm, nxit risinë dhe krijimtarinë, si dhe ndikon në rritjen e punësimit dhe sidomos konkurrencës.

³ I. Londo (2007) "E Drejta e Autorit", Instituti Shqiptar i Medias;

⁴ Scott B., Copyright in a frictionless world, First Monday, volume 6, number 9, (September 2001) f.21-24;

⁵ European Law Journal, Vol. 13, No. 5, September 2007, pp. 680-694., Journal compilation © 2007 Blackwell Publishing Ltd, f.13-14;

⁶ Geller P.E., International Copyright Law and Practise, (2000), f. 98-102;

¹ Holleman J. R. (2002), Comments on standards setting and intellectual property, f. 23.

² Traktati "Për të drejtën e autorit" (WCT) (1996) dhe Traktati "Për artistët ekzekutues dhe interpretues, prodhimet e fonogrameve" (ËPPT) (1996), Marrëveshja e TRIPS-it (1994) etj.

1. Legjislacioni i së Drejtës së Autorit në Bashkimin European

1.1. Legjislacioni i BE-së për të drejtën e autorit

Këshilli i Ministrave dhe Parlamenti European kanë miratuar 7 (shtatë) Direktiva⁷, të cilat janë të fokusuara në çështjen e mbrojtjes dhe garantimit të së drejtës së autorit në BE. Shtetet Anëtare janë të detyruara t'i zbatojnë dhe t'i inkorporojnë këto Direktiva në legjislacionin e tyre të brendshëm.

Përpjekjet për të harmonizuar të drejtën e autorit në Europë (dhe më tej) fillojnë pikërisht me Konventën e Bernës “Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike” (1886). Të gjitha Vendet Anëtare të Bashkimit European e kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Bernës (1886) dhe përshtatja e legjislacioneve kombëtare me dispozitat e kësaj Konvente ka qenë e detyrueshme për të gjitha vendet europiane, të cilat dëshirojnë të pranohen në Bashkimin European. Referuar edhe dispozitave të Konventës së Bernës (1886), mbrojtja e së drejtës së autorit në BE është automatike, e menjëherëshme dhe nuk është e nevojshme të kryhet një regjistrim formal i veprës. Në të njëjtën kohë, dispozitat e kësaj Konvente janë fleksibël dhe i lejojnë Vendet Anëtare të Bashkimit European, që t'u ofrojnë veprave letrare dhe artistike, afate më të gjata mbrojtjeje, sesa ato të përcaktuara në këtë Konventë.

Megjithatë, hapi i parë, i madh, për harmonizimin e ligjeve kombëtare të së drejtës së autorit, u ndërmor nga Komuniteti Ekonomik European, me idenë e zbatimit të standarteve të përbashkëta për mbrojtjen e programeve kompjuterike, pikërisht me miratimin e Direktivës⁸ “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike” (91/250/EEC), në vitin 1991. Sigurisht që një Direktivë e tillë u konsiderua mëse e nevojshme, duke patur parasysh zhvillimin ekonomik dhe teknologjik që kishte përfshirë të gjitha Shtetet Anëtare, si dhe duke ndjerë domosdoshmërinë e unifikimit të dispozitave mbrojtëse të programeve kompjuterike në Bashkimin European.

⁷ Council Directive 91/250/EEC of 14 May 1991 “On the legal protection of computer programs”; Council Directive 92/100/EEC of 19 November 1992 “On rental right and lending right and on certain rights related to copyright in the field of intellectual property”; Council Directive 93/98/EEC of 29 October 1993 “On harmonizing the term of protection of copyright and certain related rights”; Directive 96/9/EC of the European Parliament and of the Council of 11 March 1996 “On the legal protection of databases”; Directive 2001/29/EC of the European Parliament and of the Council of 22 May 2001 “On the harmonisation of certain aspects of copyright and related rights in the information society”; Directive 2001/84/EC of the European Parliament and of the Council of 27 September 2001 “On the resale right for the benefit of the author of an original work of art”; Directive 2004/48/EC of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 “On measures and procedures to ensure the enforcement of intellectual property rights”;

⁸ Council Directive 91/250/EEC of 14 May 1991 “On the legal protection of computer programs”;

Vetëm 2 vjet më vonë, Direktiva e sipërpërmendur u ndoq nga Direktiva⁹ (93/98/EEC), miratuar nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet së cilës u mundësua harmonizimi i afateve të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave (fquinje) të lidhura me të. Në këtë mënyrë, u vendos një afat i përbashkët i mbrojtjes së të drejtës së autorit deri në 70 vjet *post mortem auctoris* (pas vdekjes së autorit).

Më pas, filluan të miratohen Direktiva të tjera, të cilat parashikonin mbrojtje të veçantë për vepra të tjera si fonogramet, database-t¹⁰, fotografitë etj., por jo të gjitha u miratuan pa diskutime dhe debate të gjata ndërmjet përfaqësuesve të Shteteve Anëtarë. Implementimi i Direktivave të Këshillit të Ministrave të BE-së mbi të drejtën e autorit ka qënë tepër i diskutuar, fakt që mund të vihet re në 6 (gjashtë) çështje gjyqësore të dërguara për gjykim pranë Gjykatës Europiane të Drejtësisë, për moszbatim të Direktivës (2001/29/EC) mbi të drejtën e autorit në BE.

Direktiva¹¹ 2001/29/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit të Ministrave, datë 22 maj 2001, e njohur shkurtimisht me emrin Direktiva e Bashkimit European për të Drejtën e Autorit, synon të harmonizojë disa aspekte të së drejtës së autorit¹² dhe të drejtave të lidhura me to (të drejtat fqinje) në shoqërinë e informacionit. Kjo Direktivë u hartua dhe miratua si rezultat i ndikimit që patën dy traktatet e Eipo-s në vitin 1996, përkatësisht Traktati “Për të drejtën e autorit” (1996) dhe Traktati “Për artistët ekzekutues dhe interpretues, prodhimet e fonogrameve”. Direktiva në fjalë ka hyrë në fuqi në qershor 2001 dhe duhej të kthehej në ligj të brendshëm të shteteve anëtarë brenda datës 22 dhjetor 2002. Shtetet anëtare mund ta bënin këtë duke u bërë ndryshime ligjeve të tyre ekzistuese për të drejtën e autorit dhe duke i përshtatur ato me Direktivën e sipërpërmendur. Deri në vitin 2005, kjo Direktivë u kthye në ligj të brendshëm për Austrinë, Greqinë, Italinë dhe Danimarkën, ndërkohë që shtetet e tjera e kanë shtyrë zbatimin e saj nën presionin e lobeve të brendshme.

Në vitet në vijim u miratuan Direktiva e tjera, që plotësuan kuadrin ligjor të legjislacionit të Bashkimit European për mbrojtjen e së drejtës së autorit. Këto Direktiva ndikuan pozitivisht, në forcimin dhe unifikimin e metëjshëm të legjislacionit të Bashkimit European, në fushën e të drejtës së autorit.

1.2. Disa karakteristika të së drejtës së autorit në Bashkimin European

Mbrojtja e të drejtës së autorit në Bashkimin European konsiderohet si një ndër çështjet më të rëndësishme të ditëve të sotme. Kjo mbrojtje u ofrohet të gjithë autorëve, të cilët kërkojnë të mbrojnë veprat letrare, artistike dhe muzikore, të

⁹ Council Directive 93/98/EEC of 29 October 1993 “On harmonizing the term of protection of copyright and certain related rights”;

¹⁰ Directive 96/9/EC of the European Parliament and of the Council of 11 March 1996 “On the legal protection of databases”;

¹¹ Directive 2001/29/EC of the European Parliament and of the Council of 22 May 2001 “On the harmonisation of certain aspects of copyright and related rights in the information society”;

¹² A. De Robbio (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy, f. 24.

shprehura në trajtën apo formën e librave, pikturave, skulpturave, filmave, inçizimeve apo programeve kompjuterike dhe bazave të të dhënave (databases). Përveç të drejtës së autorit, legjislacioni i BE-së i siguron një mbrojtje të veçantë edhe të drejtave fqinje me të drejtën e autorit. Këto të drejta përfshijnë të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese.

E drejta e autorit nuk mbron idetë, por vetëm shprehjen e tyre në krijime të veçanta. Kjo kërkesë krijon mundësinë e pajtimit të interesave të krijuesve dhe të shoqërisë, duke mbrojtur lëvizjen e lirë të ideve. Pra, e drejta e autorit mbron formën që i është dhënë një ideje të caktuar.

Mbrojtja e së drejtës së autorit në Bashkimin Europian i ofron krijuesit të veprës, përfitime të karakterit ekonomik, në trajtën e shpërblimit financiar për veprën e krijuar, por njëkohësisht i atribuon atij edhe përfitime me karakter moral, që konsistojnë përgjithësisht në shpalljen e autorësisë së veprës, si dhe ndalimin e shtrembërimeve¹³ ose keq informimeve, lidhur me veprën e tij. Pikërisht, mbrojtja e të drejtës së autorit bën të mundur, që krijuesi të gëzojë të drejtat ekskluzive (ekonomike) dhe të drejtat morale të veprës së tij.

Në shumicën e vendeve Anëtare të BE-së, të drejtat morale janë të përjetëshme, ndërkohë që në disa vende të tjera, ato përfundojnë në të njëjtin moment me të drejtat ekonomike. Të drejtat morale janë të patransferueshme dhe autori i veprës mbetet gjithnjë zotëruesi i tyre. Sipas legjislacionit të Bashkimit Europian, të drejtat ekonomike ose *exclusive rights*, janë të drejta, që i përkasin autorit të veprës, por që me autorizimin e tij mund t'i kalojnë edhe personave të tjerë. Pra, këto të drejta janë të transferueshme dhe të përkohëshme. Sipas legjislacionit të BE-së, të drejtat ekonomike përfshijnë: të drejtën e publikimit të veprës, të drejtën e riprodhimit, të drejtën e prezantimit në publik, të drejtën e difuzionit, të drejtën për ta komunikuar në publik, të drejtën e shpërndarjes, të drejtën e përkthimit, të drejtën e dhënies hua apo me qira të veprës.

Për sa më sipër, autori i veprës ka të drejtën ekskluzive për të riprodhuar veprën dhe për t'ia komunikuar atë publikut. E drejta e riprodhimit e lejon autorin e veprës të riprodhojë të gjithë veprën ose pjesë të veçanta të saj. Çdo riprodhim i veprës duhet të autorizohet nga autori. Përgjithësisht, të drejtat ekonomike e humbin fuqinë e tyre 70 vjet pas vdekjes së autorit.

Legjislacioni i BE-së, sikurse edhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtës së autorit, theksojnë faktin që për identifikimin e autorit të veprës të përdoret referenca “© **copyright emri i autorit**”. Një referencë e tillë nuk është e detyrueshme për t'u përdorur, por është e nevojshme për të provuar autorësinë e dikujt mbi një vepër të caktuar.

Përgjithësisht, në shtetet anëtare të BE-së nuk është e nevojshme një regjistrim i veprës, sepse këto shtete janë palë në Konventën e Bernës (1886), sipas dispozitave

¹³ De Robbio A. (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy, f. 13;

të së cilës parashikohet mbrojtje e menjëhershme e veprës, që në momentin e krijimit të saj. Megjithatë, në shtetet anëtare të BE-së janë krijuar të ashtuquajturat Zyra Kombëtare të së Drejtës së Autorit (National Copyright Offices), të cilat kanë krijuar sisteme të regjistrimit, nëpërmjet së cilave, krijuesve u sigurohen përfitime dhe lehtësira të ndryshme, si psh krijuesi mund t'ia transferojë të drejtat e tij publikuesit ose prodhuesit etj.

1.2.1. *Koncepti i origjinalitetit tek veprat që gjejnë mbrojtje nga e drejta e autorit*

Në shumicën e shteteve europiane, kriteri standart për mbrojtjen e së drejtës së autorit është pikërisht *origjinaliteti i veprës*. Në këtë mënyrë, një vepër konsiderohet se përfiton mbrojtje nga e drejta e autorit, për sa kohë që ajo mendohet të jetë origjinale. Terminologjia e përdorur nga vende të ndryshme europiane, për të përcaktuar se çfarë është ajo që ka rëndësi për t'i siguruar një vepër të caktuar mbrojtje nga e drejta e autorit, është pak a shumë e njëjtë në të gjithë shtetet.

Për shembull, si në Ligjin spanjoll¹⁴ “Për të Drejtën e Autorit” (*Ley de Propiedad Intelectual*), ashtu edhe në Ligjin e Mbretërisë së Bashkuar “Mbi të drejtën e autorit, disenjot dhe patentat” (*UK Copyright, Designs and Patents Act*) përdoret shprehja “vepra origjinale”. Në të njëjtin mënyrë, edhe Copyright Act në SHBA i referohet “*original works of authorship*”, Ligji italian mbi të Drejtën e Autorit (*Legge sul Diritto d'Autore*) i referohet “*opere dell'ingegno di carattere creativo*” pra, veprave të mendjes, me natyrë krijuese, Ligji gjerman mbi të drejtën e autorit (*Urheberrechtsgesetz*) i referohet “*persönliche geistige Schöpfungen*” dhe në fund vëmë re Kodin francez për të Drejtën e Autorit (*Code de la Propriété Intellectuelle*), i cili nuk i referohet saktësisht kriterit të origjinalitetit duke iu atribuar mbrojtje “*të gjithë veprave intelektuale, pavarësisht nga forma dhe mënyra e shprehjes*”. Megjithatë, edhe në këtë rast, si literatura juridike, ashtu edhe praktika gjyqësore, bien dakord me faktin që kriteri i origjinalitetit është i nënkuptuar.

Në nivel ndërkombëtar, as Konventa e Bernës (1886) dhe as Marrëveshja e TRIP-s (1996) nuk përcaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë standartin që duhet të plotësojnë krijimet dhe veprat, në mënyrë që ato të përfitojnë mbrojtje nga e drejta e autorit. Në këtë mënyrë, vendeve palë në këto marrëveshje u është lënë shumë hapësirë për të sistemuar vetë ligjërisht këtë çështje.

Edhe Bashkimi Europian nuk ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në harmonizimin e standartit të origjinalitetit që duhet të plotësojnë krijimet dhe veprat për të përfituar mbrojtje nga e drejta e autorit. Standarti i kërkuar deri tani është arritur të harmonizohet për 3 kategori veprash të mbrojtura nga e drejta e autorit, përkatësisht për bazat e të dhënave (neni 3.1, i Direktivës së BE-së “Për mbrojtjen e bazave të të dhënave”, fotografitë (neni 6 i Direktivës “Për harmonizimin

¹⁴ Balañá Vicente S. (2007) “The Originality Requirement in Copyright Law - A Comparative Study Between the Spanish, French, UK, US, German, and Italian Jurisdictions”, f. 32-33;

e afateve të mbrojtjes të së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të lidhura me të” dhe programet kompjuterike (neni 1, pika 3, i Direktivës së Be-së “Për mbrojtjen e programeve kompjuterike”. Standarti i BE-së për *“origjinalitetin”* për sa i përket bazave të të dhënave, programeve kompjuterike, dhe fotografive është se për këto vepra duhet të mendohen se janë *“krijime intelektuale të vetë autorit”*.

Sikurse u përmend edhe më sipër, në asnjë rast nuk përcaktohet saktësisht dhe nuk qartësohet se kush janë elementët më të rëndësishëm që të mund të vërtetojnë origjinalitetin e një veprë. Këto vështirësi u rritën akoma edhe më tepër, kur çështje të tilla u dërguan në gjykatë për të kryer interpretimin e të qënurit “origjinale” të një veprë, ku sigurisht që gjykata të ndryshme dhanë interpretime dhe përgjigje të ndryshme.

Ndërsa, në disa vende si Spanja dhe Franca, koncepti i origjinalitetit kuptohet si *“vulë e personalitetit të autorit”*, në vende të tjera si Britania e Madhe apo SHBA, kuptimi i këtij koncepti ka kaluar nga ideja e *“seat of the brow-djersës së ballit”* në idenë e *“të pasurit një nivel mesatar krijmtarie”*. Pra, origjinaliteti mund të jetë lehtësisht i perceptueshëm nga kushdo, por mjaft i vështirë për t’u përkufizuar.

Pra, nga sa më sipër, vende të ndryshme kanë përcaktuar standarte të ndryshme të konceptit të origjinalitetit, për të bërë të mundur mbrojtjen e veprave dhe krijimeve të autorëve, ndaj si rrjedhim të qënurit *“origjinale”* për një vepër, është e ndryshme në vende të ndryshme.

Për të gjitha veprat që gjejnë mbrojtje në mënyre specifike në legjislacionin e Bashkimit Europian, testi i origjinalitetit¹⁵ konsiston në atë që ato janë *“krijim intelektual i vetë autorit”*, përndryshe Direktiva përkatëse i referohet Nenit 2 të Konventës së Bernës (“çdo prodhim në literaturë, apo në fushën shkencore dhe artistike, në çfarëdo lloj forme apo mënyre të shprehuri”). Sikurse u përmend edhe më sipër, mbrojtja e së drejtës së autorit shtrihet në mënyrën e të shprehurit, por jo tek idetë, procedurat, metodat e të vepruarit ose konceptet matematikore, sikurse parashikohet edhe në Nenin 9 (2) të TRIPS dhe Nenin 2 të WCT.

1.2.2. Veprat e mbrojtura nga legjislacioni i së drejtës së autorit në BE

Veprat letrare dhe artistike janë të mbrojtura automatikisht, nëpërmjet dispozitave përkatëse të Konventës së Bernës (1886). Ndërkohë që, legjislacioni i BE-së i ofron mbrojtje programeve kompjuterike, në të njëjtën mënyrë sikurse Konventa e Bernës u siguron mbrojtje veprave letrare dhe artistike (neni 1, pika 1, e Direktivës 91/250/EEC), sikurse edhe neni 10 (1) i TRIPS dhe neni 4 i WCT). Fotografitë janë të mbrojtura nga e drejta e autorit, vetëm nëse ato janë krijime intelektuale të vetë autorit (neni 6, Direktiva 93/98/EC, si dhe neni 9 i WCT). Por, Shtetet Anëtare të BE-së mund të mbrojnë edhe fotografitë që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e sipërpërmendur, nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit.

¹⁵ De Robbio A. (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy, fq. 22;

Database-t (bazat e të dhënave) janë gjithashtu të mbrojtura, sikurse veprat letrare nga Konventa e Bernës (1886), në rast se ato janë krijime intelektuale në bazë të arsyes së përzgjedhjes apo përmbajtjes së tyre (neni 3, Direktiva 96/9/EC, sikurse neni 10/2 i TRIPS dhe neni 5 i WCT). Në rast të kundërt, atyre u sigurohet mbrojtje *sui generis*. Mbrojtja *sui generis*, që legjislacioni i BE-së u atribuon bazave të të dhënave, konsiderohet si elementi më i veçantë i këtij legjislacioni krahasuar me legjislacionet e vendeve të tjera apo me legjislacionin e SHBA-së.

1.2.3. Vepra të pambrojtura

Disa lloje krijimesh nuk mbrohen nga e drejta e autorit, për vetë faktin se këto krijime nuk plotësojnë kriteret për të gëzuar një mbrojtje të tillë. Në këtë kontekst, theksojmë faktin se idetë, informacionet, fjalimet politike ose vendimet gjyqësore, teoritë matematikore, algoritmat apo veprat, të cilat nuk janë origjinale, nuk gëzojnë mbrojtje nga Direktivat e BE-së.

Gjithashtu edhe ato vepra, të cilave u ka përfunduar afati i mbrojtjes së tyre (përgjithësisht 70 vjet pas vdekjes së autorit) futen automatikisht në grupin e veprave të pambrojtura.

2. Legjislacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në fushën e së drejtës së autorit

Legjislacioni i së drejtës së autorit në SHBA udhëhiqet nga i ashtuquajtimi *Copyright Act* (1976). *Copyright Act* parandalon kopjimin e paautorizuar të veprës të autorëve dhe krijuesve të veprave letrare, artistike dhe programeve kompjuterike, bazave të të dhënave etj. Në këtë kontekst, duhet theksuar fakti që nëpërmjet këtij akti ndalohet kopjimi i paautorizuar i veprës, por jo kopjimi i ideve që përmban një vepër. Sikurse është vënë re edhe në legjislacionin e BE-së, edhe në atë të SHBA-së, që një vepër të mbrohet nga e drejta e autorit duhet që kjo vepër të përmbushë kriterin e origjinalitetit, pra që vepra në fjalë të mos jetë e kopjuar, por të jetë një produkt intelektual i vetë krijuesit. Pa dashur të kalojmë në përsëritje të kriterëve apo veprave të mbrojtura nga ana e legjislacionit të SHBA-së mbi të drejtën e autorit, kalojmë në studimin e atyre që janë konsideruar si elementë të veçantë të tij.

2.1. Koncepti i “Fair Use” dhe kriteret e tij.

*Copyright Act*¹⁶ në SHBA siguron një mbrojtje të posaçme për të drejtat ekskluzive apo të drejtat ekonomike të autorit. Megjithatë, duhet theksuar fakti

¹⁶ Engle E, (2007), “When is Fair Use Fair? A Comparison of EU and US Intellectual Property Law”, f.42;

që këto të drejta nuk janë të palimituara, por mbi to ekzistojnë disa kufizime. Këto kufizime njihen nën emrin e doktrinës së “fair use”¹⁷. Kjo doktrinë është zhvilluar ndër vite nëpërmjet praktikës gjyqësore të gjykatave amerikane, të cilat janë munduar të balancojnë të drejtat e autorit me interesat e shoqërisë amerikane, për sa i përket lejimit të kopjimit të veprës në disa raste të caktuara. Kjo doktrinë ka në thelb të saj idenë që jo çdo kopjim duhet ndaluar, sidomos në rastet e kritikizmit, raportimit të lajmeve, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Megjithëse Doktrina “Fair Use” është krijuar nga praktika gjyqësore, ajo është pasqyruar në dispozitat përkatëse të *Copyright Act*¹⁸. Kështu sipas dispozitave të *Copyright Act* në disa raste lejohet kopjimi dhe shpërndarja e veprave pa lejen apo autorizimin e mbajtësit të së drejtës. Këtu nuk jepet qartësisht përkufizimi i *fair use*, por për të përcaktuar nëse një rast do të konsiderohet “fair use” duhet që të analizohen 4 faktorë të rëndësishëm:

1. qëllimi dhe karakteri i përdorimit të veprës që gëzon mbrojtje nga e drejta e autorit. Këtu, duhet patur parasysh fakti që të bëhet dallimi nëse përdorimi i saj nga një subjekt i caktuar, bëhet për qëllime tregëtare apo për qëllime edukative, pa qëllime fitimi;
2. natyra e veprës së kopjuar;
3. sasia dhe substancialiteti i ekstraktit të përdorur, në raport me veprën e kopjuar në tërësinë e saj; dhe
4. efekti ekonomik, i mbështur në vlerën e veprës së kopjuar, vlerë kjo e përcaktuar sipas tregut përkatës.

Shpeshherë është e vështirë të vendoset nëse përdorimi apo kopjimi i një vepre të caktuar përben “fair use”, sepse të katër faktorët e sipërpërmendur çojnë në rezultate konfliktuale. Gjithsesi, në çdo rast do të jenë gjykatat, ato që do të qartësojnë interpretimin e “fair use”.

Koncepti i “fair use” vihet re edhe në Britaninë e Madhe, apo në vendet e Commonëalth-it. Edhe në këto vende, kjo praktikë është vendosur nga gjykatat e më pas është inkorporuar në legjislacionet përkatëse. Por, ky koncept nuk është përkufizuar në mënyrë të qartë edhe në këto vende. Në Kanada, kopjimi për përdorim personal është parashikuar shprehimisht si i lejuar në ligjin e vitit 1999. Ndërkohë që, në Australi, përjashtimet e *fair use* që janë pjesë e *Copyright Act* 1968, përbëjnë në vetvete një grup rrethanash të caktuara, në të cilat veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit mund të kopjohen ose ndryshohen pa pëlqimin apo autorizimin e autorit, krijuesit apo mbajtësit të të drejtave. Në ligjin aktual

¹⁷ “Fair Use” përkthehet “përdorim i drejtë”.

¹⁸ Article 17 U.S.C. § 107;

australian ekziston sërish dispozita, sipas së cilës materialet apo veprat e mbrojtura me të drejtën e autorit mund të riprodhohen ose ndryshohen për përdorim personal pa lejen e autorit.

Në SHBA, akti ligjor i njohur si AHRA (Audio Home Recording Act, 1992) ndalon marrjen e masave apo sanksioneve të ndryshme ndaj konsumatorëve, që bëjnë kopje të disqeve muzikore për qëllime jo tregëtare, kundrejt pagesës dhe ushtrimit të mekanizmave kontrollues detyrues të kopjeve.

Akte të tjera ligjore që kanë amenduar Copyright Act të SHBA-së, kanë vendosur se bërja e një kopjeje të plotë të një vepre, ose të një pjese të veprës, për qëllime tregëtare, nuk do të konsiderohet si *fair use*.

2.2. Licencat e detyrueshme

Përgjithësisht, të drejtat ekonomike të pranuar nga Copyright Act mund të ushtrohen nga mbajtësi i së drejtës së autorit në mënyrën që ai e konsideron të përshtatshme. Nëse autori i një dorëshkrimi nuk dëshiron që vepra e tij të publikohet apo shpërndahet, atëherë ai në cilësinë e mbajtësit të së drejtave ekonomike mbi veprën përkatëse, mund të ndalojë publikimin dhe shpërndarjen e këtij dorëshkrimi. Në mënyrë të ngjashme, këto të drejta mund të kontrollohen sipas mënyrës që mbajtësi i të drejtës dëshiron, nëpërmjet licencave. Megjithatë, ka disa përjashtime nga ky rregull, të cilat janë pasqyruar në *Copyright Act* dhe shprehen nëpërmjet **licencave të detyrueshme**. Licencat e detyrueshme janë të kufizuara dhe zbatohen vetëm në 5 rrethana të caktuara:

- Për prodhimin e inçizimeve të reja muzikore, që mbështeten në inçizime muzikore ekzistuese, me natyrë jo dramatike;
- Për shfaqjen e një inçizimi muzikor, me natyrë jo dramatike, në një gramafon me monedhë (juke-box);
- Për rintransmetimin simultan nga operatorë të sinjalit televiziv kabllor;
- Për shfaqjen, paraqitjen dhe inçizimin e veprave të caktuara nga entitete transmetuese publike;
- Për ushtrimin e së drejtës së përkohshme për të ritransmetuar sinjalet televizive në rrugë satelitore për tek antenat satelitore private.

Copyright Act trajton edhe çështje të tjera që trajtohen edhe në Direktivat e BE-së, të cilat janë pothuajse të ngjashme. Kjo ndodh për shkak të përmasave globale që kanë marrë Konventat dhe Traktatet në fushën e të drejtave të autorit, të cilat janë munduar të unifikojnë parimet dhe konceptet kryesore të së drejtës së autorit në botë.

3. Konkluzione mbi dallimet dhe përparësitë e legjislacioneve të BE-së dhe SHBA-së në fushën e së drejtës së autorit

3.1. Vështrim i përgjithshëm

E drejta e autorit ka gjetur mbrojtje nga shumica e legjislacioneve në botë. Megjithatë, mbrojtja që i bëhet kësaj të drejte nuk është kudo e njëjtë. Kështu, mënyra e realizimit të mbrojtjes ligjore që i sigurohet së drejtës së autorit në SHBA ndryshon nga ajo europiane, sepse edhe vetë legjislacionet respektive janë zhvilluar mbi baza dhe koncepte të ndryshme ligjore.

Legjislacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës¹⁹ në fushën e së drejtës së autorit mbështetet në Common Law dhe në konceptin e të ashtuquajturit “Fair Use”, ndërsa sistemi evropian i së drejtës së autorit e ka origjinën e tij nga e drejta romake dhe nga e ashtuquajtura “paternity right”.

Pjesa më e madhe e vendeve europiane, markat dhe patentat i identifikojnë me termin “Pronësi Industriale”, ndërkohë që në SHBA, për të dyja kategoritë (e drejta e autorit dhe pronësia industriale) përdoret termi “Pronësi Intelektuale”.

Termi “copyright” që përdoret në SHBA reflekton pikërisht orientimin e SHBA-së në trajtimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. E drejta amerikane thekson rolin ekonomik të së drejtës së autorit. Pra, synimi kryesor në këtë rast është mbrojtja e të drejtave ekonomike (ecscluzive rights).

Tradicionalisht, në SHBA “copyright”-i është parë si një e drejtë që synon të nxisë zhvillimin e artit, ndërsa mbrojtja e autorit e veprës është parë vetëm si rruga apo mjeti për ta arritur këtë synim, por nuk është vetë synimi. Kjo duke qartë në Nenin 1, Par. 8 të Kushtetutës Amerikane²⁰ ku parashikohet: “Kongresi gëzon të drejtën të nxisë zhvillimin e arteve të dobishme, duke u siguruar për afate kohore të kufizuara autorëve... të drejta ekskluzive në lidhje me shkrimet.... e tyre”.

Në Evropë ndodh e kundërta. Legjislacioni evropian në këtë fushë, kur mbron veprën, synon të mbrojë autorin si individ. Në të drejtën kontinentale, e drejta e autorit buron nga të drejtat e personalitetit të krijuesit. Të drejtat e autorit bazohen kryesisht në nocionet e së drejtës natyrore: “Të drejtat e autorit nuk krijohen nga ligji, por kanë ekzistuar gjithmonë në ndërgjegjin e njeriut”. Në filozofinë e pastër të “droit d’auteur”, e drejta e autorit është thelbësisht një e drejtë natyrore e pakufizuar, që reflekton lidhjen e ngushtë ndërmjet autorit dhe krijimit të tij, personal. Ky perceptim është reflektuar edhe në emrin “e drejtë e autorit”. Mbrojtja synon të respektojë veprimtarinë krijuese dhe shtrihet, përtej përfitimeve ekonomike edhe tek të drejtat morale.

¹⁹ Ravicher M., (2007), “Originality Requirements under U.S. and E.U. Copyright Law”, f.17-18;

²⁰ USA Constitution Act, Section 8.

3.2. Roli i të drejtave morale në legjislacionin e USA dhe vendeve të BE-së

Në Europë sistemi “droit d’auteur” është i orientuar për mbrojtjen e autorit, ndërkohë që në sistemin “copyright” të SHBA-së, sikurse u përmend edhe më sipër, të drejtat morale nuk gjejnë mbrojtje dhe me “copyright” do të kuptohet e drejta e përdoruesit për të bërë një kopje të veprës. Pra, dallimi kryesor ndërmjet dy sistemeve është pikërisht trajtimi i të drejtave morale apo “les droits morale”.

Për të argumentuar sa më sipër, diskutojmë çështjen gjyqësore të Campbell v. Acuff Rose²¹, të gjykuar në një gjykatë të SHBA. Në këtë çështje, grupi muzikor rap “Tëo Live Creë” përdori këngën e famshme të Roy Robinson “Pretty Woman” si model të njëres prej këngëve rap në një album të tij, pa lejen paraprake të Orbinsonit. Gjykata e Lartë amerikane u shpreh në favor të “Tëo Live Creë”, sepse sipas gjykimit të saj përdorimi i veprës përfshihej në kategorinë e “fair use”, për shkak se grupi rrepist e kishte përdorur këngën për të parodizuar veprën origjinale. Theksojmë faktin se paroditë dhe satirat janë të mirënjohura në praktikën gjyqësore amerikane si raste të mirëfillta të “fair use”.

Në rast se çështja e sipërpërmendur do të ishte gjykuar në Evropë, Acuff-Rose nuk do ta kishte fituar çështjen. Një gjykatë europiane në vendimin e saj do të kishte arsyetuar që një rast i tillë ishte një shkelje e hapur e të drejtave morale të autorit të këngës, duke i ndryshuar dhe parodizuar lirikën e këngës.

3.3. Ndryshime dhe përparësi të dy legjislacioneve në fushën e së drejtës së autorit

Dallimi midis copyright-it në vendet e Common Law dhe të drejtës së autorit në vendet e Civil Law reflektohet në dispozita të ndryshme të ligjeve respektive të vendeve që u përkasin këtyre sistemeve: psh. Tradita anglo-amerikane i jep mbrojtje edhe regjistrimeve të tingujve (fonogrameve) dhe programeve radio-televizive, ndërsa tradita kontinentale europiane përdor një grup më vete për këto vepra, që quhet “neighboring rights” ose të drejtat fqinje.

Kur vepra krijohet gjatë një marrëdhënieje pune, e drejta anglo-amerikane njeh pronar të parë të copyright-it, punëdhënësin e autorit, ndërsa e drejta kontinentale europiane konsideron pronar vetë autorin. Sikurse përmendëm edhe më sipër, në të drejtën anglo-amerikane, të drejtave morale nuk u sigurohet mbrojtje në nivelin e të drejtave ekonomike, ndërkohë që në të drejtën kontinentale europiane, që përfshin legjislacionet e Vendeve Anëtare të BE-së, por edhe legjislacionet e vendeve të tjera europiane, të drejtat morale kanë një rëndësi të veçantë dhe mbrohen posaçërisht.

²¹ Simpson B., (2004) Copying case highlights of EU over US law, pages 34-35;

Në disa raste, e drejta e autorit e inkorporuar në Direktivat e BE-së u garanton një mbrojtje më efikase veprave të caktuara. Për të qënë më konkretë, i referohemi mbrojtjes ligjore që SHBA dhe BE i japin bazave të të dhënave.

Megjithëse, bazat e të dhënave mbrohen si të tilla nga ligji i copyright-it në SHBA, të dhënave të veçanta të tyre (brenda/në përmbajtjen e bazës së të dhënave) nuk u garantohet automatikisht mbrojtje ligjore. Sipas *Copyright Act* mbrojtja i sigurohet vetëm bazës së të dhënave në tërësi, por kjo mbrojtje nuk shtrihet edhe tek të dhëna të veçanta në brendësi të kësaj bazë të të dhënave.[17 U.S.C.§103(b)] Pra, një bazë të dhënash mbrohet vetëm në tërësinë e saj. Kështu, për të qartësuar sa më sipër, japim një shembull. Në një database të citimeve që kanë bërë presidentët e SHBA-së ndër vite, nuk do të konsiderohet shkelje nxjerrja apo kopjimi nga kjo bazë të dhënash, të një citimi apo thënieje të Xhorxh Uashingtonit, por do të konsiderohej shkelje vetëm kopjimi i të gjithë database-it, për sa kohë që database-i i plotëson kërkesat e origjinalitetit dhe krijmtarisë sipas vendimit të gjykatës amerikane në çështjen *Feist*.

Në çështjen **Feist²² Publication, Inc. V. Rural Telephone Service Company, Inc.**, Gjykata e Lartë e SHBA-së vendosi që një vepër e përpiluar në formën e një baze të dhënash (database) duhet të përmbajë një nivel minimal krijmtarie në mënyrë që të mund të gëzojë mbrojtje ligjore nga *Copyright Act*.

Rural Telephone Service Company, Inc. ishte një shoqëri telefonike, lokale në Kansas (SHBA) që botonte numratorë telefonikë, me të dhënat e përfitura nga pajtimtarët e saj. *Feist Publications, Inc.* ishte një botues numratorësh telefonikë që mbulonte një territor në një shkallë të madhe gjeografike. Për të botuar numratorin e tij telefonik, *Feist Publications, Inc.* kishte nevojë për të dhënat që *Rural Telephone Service Company, Inc.* kishte elektronikisht në database-in e tij. Fillimisht *Feist Publications, Inc.* u mundua të liçensonte informacionin drejtpërdrejt nga numratorët telefonikë të *Rural Telephone Service Company, Inc.*, por kur ky i fundit refuzoi, *Feist Publications, Inc.* kopjoi elektronikisht listat e pajtimtarëve nga direktoria elektronike e *Rural Telephone Service Company, Inc.* Megjithëse, *Feist Publications* e ndryshoi shumë renditjen e pajtimtareve dhe të dhënave të tyre nga listat e kopjuara nga *Rural Telephone Service Company*, sërisht shumë të dhëna të tjera ishin identike me listat e numratorëve të këtij të fundit.

Për këtë arsye, *Rural Telephone Service Company* e paditi *Feist Publications* për shkelje të së drejtës së autorit, duke kopjuar database-in e tij, mbi bazën e të cilit kjo shoqëri botonte numratorët telefonikë për pajtimtarët e saj.

Dy gjykata lokale i dhanë të drejte *Rural Telephone Service Company*, duke e konsideruar shkelje të së drejtës së autorit veprimin e *Feist Publications*. Megjithatë, Gjykata e Lartë vendosi që në këtë rast nuk kishin të bënin me shkelje të së drejtës së autorit. Sipas Gjykatës së Lartë, ekstraktet e të dhënave apo përzjerjet

e të dhënave të database-ve janë të pambrojtur nga e drejta e autorit. Mbrojtja do të ekzistonte vetëm në rast se të dhënat do të ishin të kopjuara, renditur dhe klasifikuar në mënyrë identike si vepra origjinale dhe pikërisht në këtë rast do të konsiderohej se *Feist Publications* do të kishte shkelur të drejtën e autorit kundrejt *Rural Telephone Service Company*.

Mbrojtja e kufizuar e bazave të të dhënave në SHBA, ka bërë të nevojshme që autorët e tyre t'i mbrojnë këto të fundit nëpërmjet kontratave. Vetëm nëpërmjet një kontrate apo liçence përdorimi për database-in, autorët e tyre mund të parandalojnë nxjerrjen ose kopjimin e ekstrakteve nga database-i original. Për shembull, një kontrate mund të ndalojë një përdorues të kopjojë ekstrakte të saj, apo t'i përfshijë këto ekstrakte në një database të ri, duke e bërë këtë database të disponueshëm vetëm për persona të autorizuar.

Ndërkohë, mbrojtja ligjore që iu rezervohet bazave të të dhënave në Europë, është më e madhe. Në bazë të Direktivës "Mbi mbrojtjen e databaseve", 11 mars 1996, një database mund të mbrohet në dy mënyra.

Së pari, Direktiva parashikon se database-t do të mbrohen nga ligji për të drejtën e autorit vetëm kur seleksionimi ose sistemimi i të dhënave në të përbën një krijim intelektual të vetë autorit. Ky parashikim ligjor është pak a shumë i njëjtë me atë të SHBA-së.

Së dyti, Direktiva i siguron mbrojtje *sui generis* bazave të të dhënave, duke ndaluar kopjimin apo nxjerrjen e ekstrakteve nga to. Efektivisht, kjo Direktivë u jep database-ve në Europë mbrojtjen që rrjedh nga parimi "djersa e ballit", parim i cili u përjashtua nga çështja *Feist* në SHBA. E drejta e mbrojtjes *sui generis* zgjat për 15 vjet nga data e krijimit të database-it.

Në disfavor të interesave amerikane, në Europë²³, e drejta *sui generis* aplikohet vetëm për database-t e krijuara nga kompanitë/shoqëritë në vendet e BE-së. Për këtë arsye, kompanitë europiane përfitojnë me tepër mbrojtje, në lidhje me bazat e tyre të të dhënave, se kompanitë amerikane.

Tradita ligjore amerikano-veriore ka pasur ndikimet e saj edhe në Europë. Kështu, legjislacioni mbi të drejtën e autorit në Britaninë e Madhe, edhe pse paksa i ndryshëm nga ai i SHBA, është jo pak i ndikuar nga ai, sepse të dy legjislacionet mbështeten fuqimisht në Common Law. Megjithatë, duhet theksuar fakti që Direktivat e BE-së në fushën e të drejtave të autorit kanë pasur një ndikim shumë të fuqishëm në Angli, për vetë faktin se këto Direktiva kanë qënë të detyrueshme për zbatim në të gjitha vendet e BE-së, ku bën pjesë edhe Britania e Madhe.

Megjithatë, si rrjedhim i Marrëveshjeve dhe Traktateve Ndërkombetare mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit, ligjet europiane dhe amerikano-veriore në këtë fushë janë përafër, duke bërë të mundur zbutjen e ndryshimeve dhe diferencave në trajtimin e këtyre çështjeve.

²² Simpson B., (2004), Coping case highlights of EU over US law, fq. 98-104;

²³ Hugenholtz, P.B., (2000) Copyright & freedom of expression in Europe, fq. 85-89;

Bibliografia

1. Council Directive 91/250/EEC of 14 May 1991 “On the legal protection of computer programs”;
2. Council Directive 92/100/EEC of 19 November 1992 “On rental right and lending right and on certain rights related to copyright in the field of intellectual property”;
3. Council Directive 93/98/EEC of 29 October 1993 “On harmonizing the term of protection of copyright and certain related rights”;
4. Directive 96/9/EC of the European Parliament and of the Council of 11 March 1996 “On the legal protection of databases”;
5. Directive 2001/29/EC of the European Parliament and of the Council of 22 May 2001 “On the harmonisation of certain aspects of copyright and related rights in the information society”;
6. Directive 2001/84/EC of the European Parliament and of the Council of 27 September 2001 “On the resale right for the benefit of the author of an original work of art”;
7. Directive 2004/48/EC of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 “On measures and procedures to ensure the enforcement of intellectual property rights”;
8. Koçi E., (2005), “Pronësia Intelektuale”, Shtëpia Botuese “Erik”;
9. S.Balaña Vicente (2007) “The Originality Requirement in Copyright Law - A Comparative Study Between the Spanish, French, UK, US, German, and Italian Jurisdictions”;
10. Loëenstein J. (2002), “The author’s due: Printing and the prehistory of copyright”, University of Chicago Press.
11. Hugenholtz, P.B, (2000) Copyright & freedom of expression in Europe.
12. May C. (2002), “The Venetian moment: New technologies, legal innovation and the institutional origins of intellectual property”;
13. Patterson L.R., (1999) “Copyright in historical perspective”, Vanderbilt University Press;
14. Birrel A., 1899, (1971 Reprint), Seven Lectures on the law and history on copyright books, Rothman Reprints Inc.;
15. Holleman J. R. (2002), Comments on standards setting and intellectual property;
16. De Robbio A. (2006) “Copyright in Europe”, Università di Padova – Italy;
17. Homiller D. P. (2006) “The Digital Millennium Copyright Act and the European Union Copyright Directive: Next Steps”;
18. Engle E., (2007), “When is Fair Use Fair? A Comparison of EU and US Intellectual Property Law”;
19. Ravicher M., (2007), “Originality Requirements under U.S. and E.U. Copyright Law”;
20. Simpson B., (2004) Copying case highlights of EU over US law,
21. Londo I. (2007) “E Drejta e Autorit”, Instituti Shqiptar i Medias;
22. European Commission, (2005), Study on a community initiative on the cross-border collective management of copyright;
23. Report on responses to the European Commission Green Paper on Counterfeiting and Piracy, June 1999;
24. European Law Journal, Vol. 13, No. 5, September 2007, pp. 680–694., Journal compilation © 2007 Blackwell Publishing Ltd,
25. Summary of Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works (1886);
26. Summary of WIPO Copyright Treaty (WCT) (1996);
27. Summary of WIPO Performances and Phonograms Treaty (WPPT) (1996);

RECENSË